



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2018:040308

Datë: 28.05.2019

Numri i dokumentit: 00333089

**P nr.106/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË – DEPARTAMENTI PËR KRIME TE RENDA**, sipas Kryetares se Trupit Gjykues – Gjyqtares Lumturije Muhaxheri, me pjesëmarrjen e Sekretares Juridike Shpresa Kërnja, në lëndën penale të pandehurit V. B. nga Klina , i akuzuar për shkak të veprës penale Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore ne Peje –Departamenti për Krime te Renda, PP/I nr.72/18 dt.13.12.2018, në seancën e shqyrtimit fillestar, publik të mbajtur me dt.10.05.2018, në praninë e Prokurorit të Shtetit – Valbona Disha Haxhosaj , të pandehurit V.B. dhe mbrojtëses së tij sipas detyrës zyrtare Shqipdonë Maraj, nga Istogu, me dt.10.05.2019 mur, e me dt.22.05.2019, përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

**I pandehuri V. B.** , i identifikuar në bazë të letërnjoftimit nr..., i lindur me dt...., në Pejë, e Klinë, i biri i Xhemës dhe nënës M., e gjinisë G., ka të kryer shkollën fillore, i punësuar në sigurim në sekuriti Këshillin qendror të zgjedhjeve, i martuar, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës, më parë i dënuar.

**ËSHTË FAJTOR**

**Për shkak se:**

Me dt.26.02.2018, rreth orës 15:50 minuta, në Qendrën Korrektuese Dubravë, Komuna Istog, pa autorizim posedon substance narkotike , ne atë mënyrë qe pas nje kontrolli fizik te kryer nga oficeri korektues S. I., me te dale nga salla e vizitave , tek i njeiti ne xhepin e djathte te jaknes se uniformes se burgut , i eshte gjetur e ndare ne dy pjese , e qe ka rrezultuar qe njera te jete substance bimore me ngjyre te gjelbert e llojit kanabis marihuan, me peshe neto 2.25 gram, ndersa tjetra sasi ka rezultuar te jete vaj i dendur ne forme te pastes me ngjyre kafe-zeze me permbajtje te vajit te hashishit dhe me vellim neto rreth 4 mililitra, e qe te dyja me permbajtje te Tetrahidrokanabinol-it,

- me çka ka kryer veprë penale Posedimi i paautorizuar i narkotikëve substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së.

Gjykata me aplikimin e dispozitave ligjore nga neni 4, 7, 17 par.1, 21 par.2, 41, 45, 46, 62 par.2 pika 2.7, 69, 73, 75 par.1 pika 1.3, 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPRK-së, nenit 365, 366, 453 par.4 të KPPRK-së, të pandehurin e

## **G J Y K O N**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, të cilin dënim do ta vuaj pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit, dhe

Dënim me gjobë në shumë prej 100 € (njëqind) euro, të cilën shumë është i detyruar ta paguaj në afat prej 90 (nëntëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mospagimit të dënimit me gjobë, do të zëvendësohet me dënim me burgim, në kohë zgjatje prej 5 (pesë) ditëve, ashtu që çdo 20 € (njëzetë) euro, të dënimit me gjobë, i përcakton 1 (një) ditë burg.

Ndaj të pandehurit shqiptohet dënimi plotësues konfiskimi i substancës bimore me ngjyre të gjelbër e llojit kanabis marihuan, me peshe neto 2.25 gram, dhe vaj i dendur në formë të pastës me ngjyre kafe-zeze me përmbajtje të vajit të hashishit dhe me vëllim neto rreth 4 mililitra, dhe pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi urdhërohet shkatërrimi i saj, numri i rastit në polici ... të dt.04.07.2018.

I pandehuri lirohet nga të gjitha obligimet si pagimi i shpenzimeve procedurale e, po ashtu edhe nga taksa për kompensimin e viktimave, për shkak të gjendjes së tij ekonomike dhe të njëjtat bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

## **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Pejë - Departamenti për Krime të Renda në Pejë, ka ngrit aktakuzë, PP/I nr.72/18 dt.13.12.2018, kundër të pandehurit V. B. nga Klina, për shkak të veprës penale "Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psiko trope dhe analoge", nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pik 1.8 të KPRK-së.

Në seancën e shqyrtimit fillestar, Gjykata duke vepruar në kuptim të nenit 246 par.4 të KPPK-se, të pandehurit i ka dhënë mundësinë që të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë. Me këtë rast, Gjykata, edhe një herë e ka udhëzuar të pandehurin për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë në kuptim të nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPRK-se, kështu që i pandehuri ka deklaruar së është plotësisht i vetëdijshëm për rëndësinë e pranimit të fajësisë dhe shton së ky deklarim paraqet shprehje të vullnetit të tij të lirë, pasi që ai është kryes i kësaj veprë penale të cilën nuk ka si ta mohoj, e pranon në tërësi fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar sipas aktakuzës PP/I nr.72/18 dt.13.12.2018, dhe se pranimi i fajësisë nga ana e tij është i mbështetur edhe në provat të cilat i janë ofruar gjykatës me aktakuzë, të njëjtat i vie keq dhe shpreh pendim për rastin.

Pas deklarimit të pandehurit për pranimin e fajësisë, Kryetarja e trupit gjykues, kërkoi mendimin e vet për këtë ta japi prokurori i shtetit dhe mbrojtësja e të pandehurit.

Prokurori i Shtetit-Valbona Disha Haxhosaj, në këtë drejtim deklaroi se pajtohet në tërësi me pranimin e fajësisë nga i pandehurit, me qenë se një pranim i tillë ka mbështetje në prova në bazë të cilave është ngritur aktakuza, faktin se i pandehuri pranimin e fajësisë e beri në mënyre

te vullnetshme pa ndonjë lloj ndikimi, i propozon gjykatës që ta aprovoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, duke i propozuar Gjykatës që ti konfiskohet substanca narkotike dhe të urdhërohet shkatërrimi i saj.

Mbrojtësja e pandehurit Avokatja Shqipdonë Maraj, në seancë ka deklaruar se pasi që i pandehuri e kuptoj natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë pas këshillimit të mjaftueshëm me te, pasi që i njëjti është bindur se aktakuza ka mbështetje në provat e prezantuara nga Prokurori i shtetit, e pasi që aktakuza është e bazuar në ligj dhe nuk ka gabime ligjore teknike i propozoi gjykatës që me aktvendim të veçantë të bëjë pranimin e fajësisë nga klienti i saj .

Në vijim, Gjykata duke e shqyrtuar pranimin e fajësisë, nga ana e të pandehurit, vlerësoi së pranimit i fajësisë paraqet shprehje të vullnetit të lirë të pandehurit, pasi që ai e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe pranimit i fajit është bërë në mbështetje të fakteve të prezantuara në aktakuzë, në përputhje me kërkesat e nenit 248 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPRK-së, bazuar në te lartcekurat gjykata pranoi pranimin e fajësisë nga i pandehuri, për shkak të veprës penale “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge”, nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPPRK-së.

Me faktet e ofruara si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit.

Nga gjendja e vërtetuar faktike, siç është përshkruar në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit V. B. , qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale “Posedim i paautorizuar i narkotikëve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par.1 lidhur me nenin 281 par.1 pika 1.8 të KPPRK-së.

Sa i përket fajësisë, Gjykata ka gjetur se te i pandehuri ka ekzistuar dashja që veprën penale ta kryen në mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, pasi që i pandehuri ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer dhe e ka dëshiruar kryerjen e saj.

Gjatë procedurës penale nuk janë paraqit rrethana të cilat do ta zvogëlojnë apo përjashtojnë përgjegjësin penale të pandehurit, kështu që i njëjti është penalisht përgjegjës.

Duke pas parasysh se Gjykata ka aprovuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit në shqyrtimin fillestar, ka vërtetuar se nuk ekziston asnjë rrethanë nga neni 253 par.1 pika 1.1, 1.2, 1.3 të KPPRK-së, si dhe faktin se janë plotësuar kushtet nga neni 248 par. 4 të KPPRK-së, dhe bazuar në mendimin juridik të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës Prishtinë dhe, Gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të EULEX-it, me nr.GjA.nr.207/13 dt.19.03.2013, në këtë çështje penale nuk është mbajtur seanca e dytë e as ajo e shqyrtimi gjyqësor, një herit edhe me rastin e shpalljes së të pandehurit fajtor dhe shqiptimin e dënimit nuk është plotësuar fare trupi gjykues.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, Gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 73 par.1 të KPPRK-se. Kështu si rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata pati parasysh se i njëjti ka qenë më parë i dënuar për veprë penale të vjedhjes grabitqare, dhe këtë veprë penale e ka kryer gjatë vuajtjes së dënimit në burgun e Dubraves, fakte këto të cilat i pohoi vetë i pandehuri në seancë, Kurse si rrethana lehtësuese për të pandehurin, Gjykata ka vlerësuar faktin se i njëjti kishte sjellje korrekte gjatë procedurës penale, është penduar për veprën penale, duke i premtuar gjykatës që në të ardhmen nuk do të përsëris veprimet e tilla, sasinë e vogël të substancës narkotike e cila i është gjetur te

pandehurit, gjendjen e tij të vështirë ekonomike, i martuar, nivelin e ulet të arsimit të gjitha këto Gjykata i ka pranuar si rrethanë favorizuese. Si rrethanë tjetër posaçërisht lehtësuese gjykata e merr faktin se i pandehuri në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën pandehet, gjë që dëshmoi gatishmëri për bashkëpunim me organin e akuzës dhe me gjykatën, dhe kjo sipas vlerësimit të gjykatës paraqet pendim të sinqertë të tij dhe fillim të procesit të rehabilitimit të tij, në prezencën e këtyre rrethanave, komfori nën 75 par.1 nën par.1.3 të KPRK-së, të pandehurit e gjykoj nën minimumin ligjor, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi me të cilën do të arrihet edhe qëllimi i dënimit.

Duke i vlerësuar kështu të gjitha rrethanat e parashikuar me nenin 73 par.1 të KPRK-se, Gjykata ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është në përputhje me shkallën e përgjegjësisë penale të tij dhe me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura të shoqërisë. Gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbejë për arritjen e qëllimit të dënimit, në pengimin e të pandehurit në kryerjen e veprave penale në të ardhmen por, ai do të ndikoj edhe si preventive gjenerale për personat tjerë që të përmbahen nga kryerja e veprave penale në përputhje me nenin 41 të KPRK-së.

Duke u bazuar në nenin 62 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet dënimi plotësues, konfiskimi i substancës narkotike i përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 453 par.4 të KPRK-së, i pandehuri është liruar nga pagimi shpenzimeve procedurale dhe taksa për kompensimin e viktimave, për shkak të gjendjes tejet të vështirë ekonomike me vetë faktin se i njëjti jeton në një shtëpi me qira, si dhe duke e pas parasysh faktin se i njëjti është mbajtës i vetëm i familjes tre anëtarësh me të ardhurat e realizuara nga puna e tij si punëtor sigurimi, pagesa e këtyre shpenzimeve do të rrezikonte gjendjen materiale të pandehurit.

Nga arsyet e cekura më lartë dhe me zbatimin e nenit 365 të KPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Duke u bazuar në nenin 368 par.2 të KPRK-se, Gjykata palët në procedurë i njoftoi me paralajmërimet që shoqërojnë aktgjykimin.

**GJYKATA THEMELORE NË PEJË - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RENDA,  
P.nr.106/18 dt.10.05.2018, i përpiluar me dt.22.05.2019.**

**Sekretarja Juridike :  
Shpresa Kërnya**

**Kryetarja e Trupit Gjykoes  
Lumturije Muhaxheri**

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes së aktgjykimin. Ankesa i dërgohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.

Numri i lëndës: 2018:040308  
Datë: 28.05.2019  
Numri i dokumentit: 00333089